

V E N D I M
Nr.138, datë 31.3.1994

**PËR KOMPENSIMIN E SHPENZIMEVE NGA NDRYSHIMI I ÇMIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE DHE LËDEVE DJEGËSE**

Me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I :

I. Për efekt të ndryshimit të çmimeve të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse, t'u jepet kompensim mujor:

1. Në masën 600 lekë në muaj:

- familjeve që marrin ndihmë ekonomike të plotë sipas ligjit nr. 7710, datë 18.5.1993 "Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore".

2. Në masën deri 350 lekë në muaj :

a) Të punësuarve në sektorin shtetëror buxhetor, privat , në shoqëritë e ndërmarrjet e përbashkëta, bankat, INSIG, ndërmarrjet në vartësi të Ministrisë së Turizmit, organizatat politike e shoqërore e në shoqatat.

b) Personat që marrin pagesë papunësie sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë".

c) Personat që marrin pension sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore", ligjit nr. 4976, datë 20.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore", kur janë në banim të përhershëm në qytet, në ish- NB-të e qendra të banuara të vërtetuara nga bashkia ose komuna, si dhe personat që marrin pension nga ligji nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me përjashtim të atyre që sipas nenit 96 të këtij ligji nuk plotësojnë kushtet e ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966.

Këtë të drejtë pensionistët e mësipërm e përfitojnë edhe kur janë të punësuar ose të vetëpunësuar në sektorin privat.

d) Familjet jobujqësore që marrin ndihmë ekonomike të pjesshme mujore sipas ligjit nr. 7710, datë 18.5.1993 "Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore".

dh) Familjet bujqësore që marrin ndihmë ekonomike të pjesshme mujore sipas ligjit nr.7710, datë 18.5.1993 "Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore", dhe asnjë anëtar i familjes nuk merr kompensim në masën 350 lekë në muaj.

e) Personat që marrin ndihmë ekonomike si të paaftë sipas vendimit të Këshillit të ministrave nr.15, datë 24.1.1994 "Për pagesën e ndihmës ekonomike për personat me paaftësi", kur janë të vetëm.

f) Personat që marrin ndihmë ekonomike sipas ligjit nr. 7710, datë 18.5.1993 "Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore", vendimit të Këshillit të Ministrave nr.40, datë 29.1.1993 "Për ndihmën ekonomike për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë", si dhe sipas pikës 3 të vendimit nr. 59, datë 18.3.1983 "Për trajtimin e të huajve që strehohen në Republikën e Shqipërisë".

3. në masën 300 lekë në muaj :

- Të punësuarit në sektorin shtetëror jobuxhetor.

4. Në masën 200 lekë në muaj :

- Personat që marrin pension sipas ligjit nr.4976, datë 20.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore", dhe nuk janë me banim të përhershëm në qytet, në ish- NB-të dhe qendrat e banuara.

5. Në masën 150 lekë në muaj:

- Familjet bujqësore që marrin ndihmë ekonomike të pjesshme sipas ligjit nr.7710, datë 18.5.1993 "Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore", kur një nga anëtarët e familjes merr kompensim sipas pikës 4 të këtij vendimi.

6. Masa e kompensimit për familjet bujqësore të përmendura në germën "dh" të pikës 2 dhe pikës 5 të këtij vendimi, në çdo rast nuk kalon 350 lekë në muaj.

7. Në masën deri 700 lekë në muaj:

- Familjet që përcaktohen në pikën 2, shkronjat a, b, c, f, si dhe në pikën 3 që kanë vetëm një

person në punë a në pension ose në pagesë papunësie dhe nuk përfitojnë ndihmë ekonomike.

II Mënyra e pagesës

1. Kompensimi regjistrohet në kolonë të veçantë në borderonë e pagesës (Pagë, pension, pagesë papunësie, ndihmë etj.) dhe jepet në fillim të muajit.

2. Për të përfituar këtë kompensim vlen e njëjta deklaratë që është përdorur sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.310, datë 24.7.1992 “Për kompensimin për frymë të shpenzimeve nga rritja e çmimeve të disa artikujve ushqimorë”. Në deklaratë duhet të shtohet numri i kontratës familjare të energjisë elektrike të lidhur me ndërmarrjen elektrike.

Personat, familja e të cilëve nuk ka lidhur kontratë me ndërmarrjen elektrike, nuk e përfitojnë këtë kompensim deri në lidhjen e kontratës.

Personi që nuk deklaron të vërtetën ose nuk njofton brenda 15 ditëve, për çdo ndryshim të deklaratës, detyrohet të kthejë 20-fishin e kompensimeve të përfituara padrejtësisht, pavarësisht nga ndjekja penale që mund të bëhet. Urdhri lëshohet nga drejtuesi i ndërmarrjes ose institucionit, ku janë marrë kompensimet dhe është titull ekzekutiv.

3. Pagesa bëhet:

a) Nga qendra e punës për të punësuarit në sektorin shtetëror buxhetor, jobuxhetor, organizata politike- shoqërore e shoqata.

b) Nga drejtoritë e sigurimeve shoqërore për pensionistët. Bëjnë përjashtim pensionistët invalidë që punojnë në sektorin shtetëror buxhetor, kompensimi i të cilëve do të bëhet nga qendra e punës, dhe pensionistët invalidë që marrin edhe pagesë papunësie, kompensimi i të cilëve do të bëhet nga zyrat e punës.

Nga drejtoritë e sigurimeve shoqërore paguhet edhe kompensimi për personat që marrin ndihmë ekonomike si të paafte, kur janë të vetëm.

c) Nga zyrat e punës për personat që trajtohen me pagesë papunësie.

d) Nga bashkitë dhe komunat për familjet që marrin ndihmë ekonomike të plotë e të pjesshme.

4. Në ndërmarrjet shtetërore, institucionet shtetërore jobuxhetore dhe pjesërisht, jobuxhetore ky kompensim nuk përfshihet në pagën mesatare mujore për efekt kontrolli.

III. 1. Fondet për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike e lëndëve djegëse përballohen si vijon:

a) Nga buxheti i shtetit për ndërmarrjet e institucionet shtetërore buxhetore e jobuxhetore, si dhe për pensionet, pagesën e papunësisë e ndihmat ekonomike.

b) Nga punëdhënësit privatë, shoqëritë e ndërmarrjet e përbashkëta, bankat, INSIG-u, ndërmarrjet në vartësi të Ministrisë së Turizmit, organizatat politike e shoqërore dhe shoqatat.

2. Efektet financiare prej 3.5 miliardë lekësh që përballohen nga buxheti i shtetit për periudhën prill- dhjetor 1994 të detajohen nga Ministria e financave për çdo ministri e institucion tjetër qëndror dhe për organet e pushtetit lokal.

3. Për përballimin e vëllimit të punës që krijohet nga zbatimi i këtij vendimi, Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 1994 i shtohen 6 milionë lekë fonde page.

4. Familjet që do të kërkojnë të përfitojnë ndihmë ekonomike të pjesshme, në dokumentet e të ardhurave që do të paraqesin, detyrimisht të shënohet edhe masa e kompensimit, nëse përfitohet sipas këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. Efektet financiare i shtrin nga data 1 prill 1994 dhe pagesat e kompensimeve fillon pas datës 1 maj 1994.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi